

DEKLARATË PËLQIMI

Deklaroj dhe garantoj me vullnetin tim të plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë më lart nga unë, në këtë aplikim, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se, të dhënat e mia, do të trajtohen duke respektuar standardet më të larta të sigurisë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar, si dhe sekretin profesional,

Autorizoj Raiffeisen Bank sh.a që vetëm për qëllimin e aplikimit online për Kredi për Shtëpi të përpunojë të dhënat e mia personale, për të më kontaktuar, nëpërmjet i) sms ii) telefonate iii) poste elektronike.

Jam i vetëdijshëm se në rast se dërgoj këtë formë aplikimi online ku shpreh interesin për kredimarrje për të vijuar me aplikimin në degët e Bankës, atëherë të dhënat e mia, të deklaruara në këtë formë, do të ruhen nga Banka sipas afateve ligjore të implementuara nga Banka.

Jam i qartë gjithashtu se nëse nuk e përfundoj këtë aplikim online (duke bërë submit), të dhënat e mia personale nuk do të ruhen nga Banka në asnjë aplikacion dhe nuk do të përdoren për qëllime të tjera.

Jam në dijeni që mund të mësoj më shumë rreth të gjitha rregullave të përpunimit të të dhënave personale në faqen e internetit të Raiffeisen Bank sh.a.

<https://www.raiffeisen.al/en/> në adresën:

<https://www.raiffeisen.al/sq/rreth-nesh/faqet-footer/mbrojtja-e-te-dhenave-personale.html>

Për çdo ankesë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, mund t'i drejtohem “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.